



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e enjte, në datën 28 janar 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA shqyrtoi projektvendimin e hartuar nga KQZ “Për Miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të medias audio dhe audiovizive” dhe kërkoi përgatitjen e një relacioni të hollësishëm mbi zbatimin e detyrimeve që i ngarkohen autoritetit për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore prej OSHMA-ve.

Po ashtu, AMA në këtë mbledhje mori në shqyrtim relacionet dhe projektvendimet për heqjen/konstatimin e pavlefshmërisë së licencës/autorizimit të subjekteve debitorë ndaj AMA-s dhe/ose Buxhetit të Shtetit për vitin 2020, dhe ra dakord që këto subjekte të njoftohen në formë elektronike dhe telefonike për përmbushjen e detyrimeve financiare deri në datën 01 shkurt 2021.

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 28 janar 2021**

